



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:052263

Datë: 30.04.2019

Numri i dokumentit: 00295559

P.nr. 184/18

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore Prizren - dega në Suharekë, Gjyqtari Robert Tunaj, me sek. Juridike F. Kabashi, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. B. M. nga fsh. M., për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr. 1454-8/17 të dt. 02.10.2017, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt. 18.04.2019, në prezencë të PSH Musli Gashi, të akuzuarit dhe perf. të dëmtuarës Y. M., muarrë dhe publikisht shpalli ndërsa me datën 30.04.2019 ketë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari M. M. i lindur më dt. 09.03.1988, nga i ati B., e ëma S., jeton në fshatin M., i martuar, punëtor, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Se me dt. 21.10.2016 në lokalin e tij “K. ..” në Suharekë, me qëllim që vetit ti sjelle dobi pasurore te kunderligjshme është konstatuar se shfrytëzon energjin elektrike me një sor me numër 1579....., i cili bllobat i ka te manipuluar te hapura dhe të mbyllura teli i pllombës është i shkëputur dhe i ngjitur me letkon, në brendi sistemi i fazave e parë dhe e treta “R”, “T” janë eliminuar me çrast energjia e shfrytëzuar nuk është regjistruar, ku të dëmtuarës “KEDS” distrikti në Prizren i ka shkaktuar dem material.

Me këto veprime kryen veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP.

Gjykata në kuptim të neneve 41,42,46,51,52,73, 74 si dhe nenit 320 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

D Ë N I M I N M E G J O B Ë

Të akuzuarit M. M. ia shqipton dënimin me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind Euro)**, të cilin dënim i akuzuari duhet të paguaj në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmeris së këtij aktgjykimi, poqëse denimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht, i njëjti do të zëvendësohet me dënim burgimi **prej 10 ditësh**, duke llogaritur për 20 €, të filluar me një ditë burg, konform nenit 46 paragrafi 3 te KP, dhe

DËNIMIN ME KUSHT

Dënimin me burg prej 3 muaj, i cili nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat prej 1 viti, nuk kryen vepër të njëjtë apo të ngjajshme penale.

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor shumen prej 20 € dhe në emër të takses për kompensim të viktimave të krimit shumë prej 30 €.

E dëmtuara KEDS në Prizren, për realizimin e kërkeses pasuroro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

Arsyetim

PSH në Prizren me aktakuzen PP.II.nr.1454-8/17 të dt. 02.10.2017, ka akuzuar M. M. nga fshati M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP, aktakuzën të cilën gjatë séancës gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e saj e ka përfaqësuar PSH Musli Gashi, i cili në tërsi ngel si në aktakuzë, me kërkesë që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari në séancë nuk e ka pranuar fajsin, gjykata administroi me provat ku ka dëgjuar dëshmitarin A. D. me shifren 30..., ka bërë shiqimin në procesverbalet nr. 069... të datës 21.10.2016, procesverbali i qendres e kalibrimit nr.20... të dt. 24.11.2016, procesverbali i shqyrtimit të njësorit elektronik i dt. 11.11.2016, kalkulimi i sektorit rikthimi i humbjeve me nr. 60... të dt. 24.11.2016, si dhe fotodokumentacioni të cilat gjinden në shkresat e lëndës.

Përfaqësuesja e të dëmtuares Y. M. në seancë ka deklaruar se bazuar në provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës e kryesisht bazuar në procesverbalin e kalibrimit ku është bërë shfrytzimi i njësorit elektrik në prezenë të anëtarit të MTI është konstatuar se shfrytzimi i pa autorizuar i energjis elektrike ashtu që dyshohet në keqpërdorimin apo vjedhjen e shërbimeve me çrast ka shkaktuar dëm material në vlerë prej 4791.77 €, e bazuar në pasqyren e transakcionit këtu të dyshuarit vrejme se veprimet e tij janë recitive ku në vitin 2018 është kontaktuar edhe një shfrytzim i pa autorizuar i energjis elektrike.

Dëshmitari A. D. në seancë ka deklaruar se komisioni prej tre anëtarve dhe në mbikqyrje të përfaqësuesit të ministris – Agjenisonit të metrologjis së Kosovës ka konstatuar se njësori elektrik bllombt i ka manipuluar të hapura dhe prap të mbyllura, teli i bllombës shtetërore ka qene i keputur dhe prap i ngjitur me letkon. Demtim tjetër nga jashtë nuk është vrejetur, pas hapjes së njësorit në brendi komisioni kapercaktua se faza e pare dhe e tretë R dhe T janë të eliminuara ku si pasojë njësori elektik ka regjistruar energji për 66.66% me pak. Provat të cilat i ka gjetur komisioni janë fotografuar si dhe i është vendosur një bllomb distributive njësorit me pas për ti ruajtur gjurmet. Përveq bllombave të cekura me lartë në procesverbal njësori demtime fizike nuk ka, që nenkupton thyerje, djegëje apo shpurje etj. Percaktimi i regjistruar me pak ka ardhur pasi që dy faza regjistrojnë energji me pak 2/3.

I akuzuari në mbrojtjen e tij ka deklaruar se konsideroi se më është bërë e pa drejtë në këtë qështje pasi që nuk kam kryer këtë vepër. Kan qenë pjestaret e KEDS-it me bërë

kontrollen në lokal, unë nuk kam qene fillimisht por pasi qe me kanë ftuar në telefon punëtorët kam ardhur dhe nuk i kam penguar, kontrollat ka vazhduar për dy deri tre orë dhe me pas kam marrë një sorin me vete, ata dy tre here e kanë hapur dhe mbyllur atë një sor para se të merrnin dhe dyshoi se me veprimet e tyre janë bërë dëmtimet në një sor. Ne atë lokal unë jam qiragji qe nga viti 2012. Unë kam pas ankese në KEDS pasi qe nga rryma e dobët dy herë me janë djegur paisjet.

Nga provat e administruara gjykata me pa medyshje ka vërtetuar se me dt. 21.10.2016 në lokalitë e tij "K. ..." në Suharekë, me qëllim që vetit të sjelle dobi pasurore të kundërligjshme është konstatuar se shfrytëzon energjinë elektrike me një sor me numër 1579...., i cili blloqet i ka të manipuluar të hapura dhe të mbyllura teli i pllombës është i shkopur dhe i ngjitur me letkon, në brendi sistemi i fazave e parë dhe e tretë "R", "T" janë eliminuar me çrast energjia e shfrytëzuar nuk është regjistruar, ku të dëmtuarës "KEDS" distrikti në Prizren i ka shkaktuar dem material.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar në tërsi nga dëshmia e A. D. i cili ka provuar faktin se një sor është manipuluar, blloqet shtetërore janë dëmtuar duke kopur dhe ngjitur me letkon ato po ashtu janë eliminuar 2 fazë, faza e parë dhe e tretë "R" dhe "T" me qka një sor ka regjistruar më pakë për 66.66% energji të shpenzuar.

Këtë gjendje faktike gjykata në tërsi e ka vërtetuar edhe nga procesverbali i qendres së kalibrimit ku është konstat se blloqet shtetërore janë kopur dhe ngjitur me letkon dhe faza "R" dhe "T" nuk kanë regjistruar energjinë e shpenzuar.

Pjesërisht këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar edhe nga mbrojtja e të akuzuarit i cili ka pohuar se lokali është në shfrytëzim të tij nga viti 2012 e tani.

Gjykata mbrojtjen e të akuzuarit se nuk e ka kryer këtë vepër e vleron si përpjekje për shmangëje nga përgjegjësia penale pasi qe nuk është në përputhje me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor.

Gjykata me rastin e marrjes së vendimit mbi denimin pati parasysh rrethanat nga neni 73 dhe 74 të KP, rrethanat në të cilat vepra është kryer, shkallen e përgjegjësive penale të kryerjes, vlerën e të mirës së mbrojtur dhe dëmit të shkaktuar. Si rrethanë letësuese gjykata mori faktin se është familjar, sjelljen korrekte në gjykatë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, kurse rrethanë posaqerisht renduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës dhe paushallit gjyqësor u muarrë në kuptim të nenit 453 të KPP.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA NË SUHAREKË
P.nr. 184/18 të datës 18.04.2019

Sek. Juridike
F. Kabashi

G j y q t a r i
Robert Tunaj

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga koha e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.